



Pranuar / Dorezuar Priljena / Predato Received / Delivery	01.12.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMS/IK/7579/2022			1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.868/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabanaj-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.868/2022 të datës 06.10.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me banim në adresën [redacted] në Komunën e Prishtinës kundër organit të punësimit/Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 01.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.868/2022 e datës 06.10.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. SHFUQIZOHET** Vërejtja me Nr.Prot.01-06-3496 e datës 09.09.2022, e shqiptuar ndaj ankuesit nga Drejtori i Departamentit për Teknologji Informative në Administratën Tatimore të Kosovës dhe e njëjta **ANULOHET**.
- III. OBLIGOHET** Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke nxjerrë vendim për largimin e vërejtjes me numër të protokollit Nr.Prot.01-06-3496 të datës 09.09.2022 nga dosja e ankuesit.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Ankuesi është i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës, sipas Akt emërimit Nr.Prot.02/318/09 të datës 18.01.2013 në pozitën "Menaxher i mirëmbajtjes dhe përkrahjes së aplikacionit bazë" pranë Divizionit të mirëmbajtjes dhe përkrahjes së aplikacionit bazë në kuadër të Departamentit për teknologji informative.

Me datën 09.09.2022, Drejtori i Departamentit të Teknologjisë Informative në Administratën Tatimore të Kosovës, i ka shqiptuar ankuesit Vërejtjen me shkrim me numër Nr.Prot.01-06-3496, me arsyetimin se i njëjti nuk ka përfillur Kodin e Etikës për shkak të komunikimit zyrtar elektronik me menaxhmentin e Administratës Tatimore të Kosovës, konkretisht Drejtorin e Përgjithshëm të ATK-së lidhur me dërgimin e e-mailave zyrtar, me ç' rast ka bërë shkelje të lehtë disiplinore sipas paragrafit 4.2 dhe 4.3 të nenit 46 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ankuesi i pakënaqur me vërejtjen me shkrim të datës 09.09.2022, e shqiptuar nga ana e udhëheqësit të tij të drejtpërdrejtë, me datën 06.10.2022, ka parashtruar ankesën me Nr.Prot:5909/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se vërejtja e shqiptuar është e kundërligjshme dhe e pa bazuar, i njëjti pretendon se korrespondencën e e-mailave zyrtar të dërguar e lidh vetëm me pjesën ku i njëjti është caktuar si anëtar i grupit punues sipas vendimit të datës 22.08.2022 për themelimin e ekipit përgjegjës për zgjerimin dhe përsheptimin e qasjes për përdorimin e të dhënave të palëve të treta, e që sipas tij anëtar do duhej të caktohej dikush nga zyra e zhvillimit e jo nga divizioni i tij (konkretisht ankuesi), andaj kërkon që pas analizimit të provave dhe bazuar në dispozitat ligjore, ankesa e të njëjtit të aprovohet dhe vërejtja e shqiptuar të anulohet.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, me datën 12.10.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa kjo e fundit me datën 21.10.2022, përmes Divizionit për Burime Njerëzore, ka përcjellë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Me datën 15.11.2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK.nr.116/2022 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 06.10.2022 me Nr.Prot:5909/2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtja me shkrim me numër Nr.Prot.01-06-3496 e datës 09.09.2022; E-mailat zyrtar të datës 01.09.2022, 31.08.2022, 23.08.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 12.10.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 21.10.2022 nga Administrata Tatimore e Kosovës lidhur me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Vendimin Nr.Prot.09.06.3341 të datës 23.08.2022 nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së; Akt emërimit e ankuesit me numër Nr.Prot.02/318/09 te datës 18.01.2013; E-mailin zyrtar te datës 29.11.2022; Formularin e përshkrimit te detyrave te punës se ankuesit; Strukturën e përgjithshme organizative të Administratës Tatimore të Kosovës të datës

09.12.2019 si dhe Vendimin VK.nr.149/2022 të datës 15.11.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, pasi ka analizuar Vërejtjen me shkrim Nr.Prot.01-06-3496 të datës 09.09.2022, e shqiptuar nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, ka konstatuar se e njëjta i është shqiptuar bazuar në komunikimet elektronike të shkëmbyera ndërmjet ankuesit dhe menaxhmentit të Administratës Tatimore të Kosovës konkretisht Drejtorit të Përgjithshëm të këtij institucioni, përmes e-mailave zyrtare ndërmjet datave 23.08.2022-01.09.2022, e që lidhen me caktimin e ankuesit në kuadër të ekipit përgjegjës për zgjerimin dhe përshpejtimin e qasjes për përdorimin e të dhënave të palëve të treta, sipas Vendimit Nr.Prot.09.06.3341 të datës 23.08.2022 i nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, e ku i njëjti është caktuar anëtar në këtë grup punues dhe se e i njëjti kërkon rishqyrtim të pjesëmarrjes në këtë grup, pasi që thekson se puna me palët e treta dhe krijimi i raporteve është në kompetencë të zyrës së zhvillimit dhe zyrtarit nga kjo zyre, sepse i njëjti deklaron se ngarkimi me detyra që ju takojnë të tjerëve është shkelje e të drejtave të punëtorëve.

Kolegji i këshillit, pasi ka analizuar komunikimet elektronike të ankuesit konkretisht e-mailin zyrtar të datës 31.08.2022, ka konstatuar se i njëjti pas pranimit të vendimit lidhur me caktimin e tij si anëtar i ekipit përgjegjës për zgjerimin dhe përshpejtimin e qasjes për përdorimin e të dhënave të palëve të treta, fillimisht me mirësjellje ka reaguar në lidhje me këtë caktim dhe i ka njoftuar menaxhmentin e këtij institucioni, se citoj: *"ndërlidhja me palët e treta dhe krijimi i raporteve është në kuadër të zyrës së (nëpunësit me inicialet A) dhe ka rekomanduar që zyrtari i i përmendur në fjalë apo dikush tjetër nga kjo zyre e tij të caktohet si anëtar i grupit nga IT"*, ndërsa po në të njëjtën datë pas dërgimit të e-mailit zyrtar të dërguar nga Drejtori i përgjithshëm i këtij institucioni, ku deklaron se citoj: *"nuk jeni ju që të komentoni vendimet, ju duhet të zbatoni vendimin, andaj kryej detyrat që tu jipen nga eprorët, e mos u merr me punë që nuk ju takojnë"*, ankuesi poashtu reagon dhe deklaron se: *" pikërisht atë çfarë thua ti po e kërkoj "mos u merr me punë që nuk ju takojnë juve", pra kërkesa ime është që mos me ngarku me punë që nuk më takojnë mua dhe aq më tepër kur janë persona që paguhen për këtë punë"*, andaj mbi këto arsye, Kolegji nuk ka mundur të konstatoj se ankuesi me veprimet e tij të deklaruara në shkëmbimin e e-maileve zyrtare, ka refuzuar punët ndërlidhur me caktimin në këtë grup punues, mirëpo i njëjti vetëm ka reaguar në atë formë në drejtim të informimit, se nuk është në kompetencën e tij të kryej punët që nuk i takojnë dhe se është shumë i ngarkuar me punë dhe detyra që i ka në përshkrim të detyrave të punës duke kërkuar që të caktohet në këtë grup ndonjë zyrtarë tjetër që ndërlidhet sipas kontratës së punës me këto përgjegjësi, kështu që Kolegji me të drejtë vlerëson se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit.

Në aspekt të vërtetimit të përgjegjësisë disiplinore, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ju referua nenit 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *"1.Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatimi jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim" 1.1."ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;*



1.2.kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3.ndodhja e pasojës; 1.4.ndodhja e dëmit; dhe 1.5.lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit”, respektivisht nisur nga ky përcaktim ligjor dhe duke u bazuar në konstatimet si më lartë, Kolegji vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga elementet që do të bënte përgjegjës ankuesin lidhur me shkeljet disiplinore të pretenduara nga udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë, ngase nuk është shkaktuar asnjë pasojë me veprimet e ankuesit lidhur me reagimet në komunikimet elektronike zyrtare dhe se i njëjti vazhdon sipas vendimit të lartcekur të jetë anëtar i grupit punues të lartpërmendur. Andaj për rastin konkret, Udhëheqësi i drejtpërdrejtë me rastin e ndërmarrjes së veprimeve ligjore lidhur me shqiptimin e vërejtjes me shkrim ndaj ankuesit, ka vepruar në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësitë e nenit 48 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, në të cilin përcaktohet se: “2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil”, e po ashtu edhe në pajtim me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, në të cilën përcaktohet se: “2. Masa disiplinore e përcaktuar në nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil, nëse nëpunësi ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.2...”.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenet 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana dhe në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.868/2022, datë 01/12/2022.

Ardita Perçuku-Shyti



Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Vendimi i dërgohet;

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm në Administratën Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.